



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij, më datë 15.07.2022, mori në shqyrtim aplikimin e Entit Rregullator të Ujit për miratimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA.

ERRU ka informuar Autoritetin e Konkurrencës se ka përfunduar procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të aplikimit të ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Konsipol SHA për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë, të cilat konsistojnë në ligjërimin e nivelit të tarifave të këtij shërbimi për të tre kategoritë e klientëve.

ERRU ka gjykuar të argumentuar nivelin tarifor të propozuar nga ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA. Në cilësinë e rregullatorit, lidhur me vlerësimin e kostove së arritshme të një ndërmarrje UK, ERRU përdor si bazë kostot sipas shërbimeve, duke siguruar një nivel të arsyeshëm rritje tarifash në raport me shërbimin e ofruar si dhe të cilësisë së shërbimit. Në analizën ekonomiko-financiare të saj, ERRU ka analizuar drejtë dhe ka marrë në konsideratë vetëm kostot e justifikuara të paraqitura nga ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA, të cilat përcaktojnë nevojat për të ardhura të ndërmarrjes si faktori bazë përcaktues në procesin e miratimit të tarifave si dhe ka përcaktuar objektivat e performancës tekniko-financiare të shoqërisë.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 900, datë 15.07.2022, vendosi t'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit, që tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Konispol SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve, të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit dhe të jenë transparente në faqen e ERRU-së.

Për më shumë shikoni Vendimin Nr. 900, datë 15.07.2022, në <http://caa.gov.al/>.